



UNIVERSITETI I PRISHTINËS UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 11793
Datë: 17/ 7/ 2025

Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës, bazuar në dispozitat e nenit 14, pika 1 e Statutit të UP-së, si dhe në dispozitat e nenit 3, nenit 19, pika 8, nenit 21, pika 1, dhe nenit 28, pika 1, nënpika 1.4, të Rregullores së punës nr. 280, të datës 13.2.2025, pas shqyrtimit të kërkesës së prof. Eliot Bytyçit, përmes e-mailit të datës 29.5.2025, për themelimin e Qendrës për Inteligjencë Artificiale në Universitetin e Prishtinës (AIUP), në mbledhjen e mbajtur më 19.06.2025, jep këtë:

P Ë L Q I M

- I. Pëlqim për themelimin e Qendrës për Inteligjencë Artificiale në kuadër të Universitetit të Prishtinës (AIUP).
- II. Detyrat dhe kompetencat e Qendrës për Inteligjencë Artificiale në Universitetin e Prishtinës (AIUP) do të përshkruhen me statutin e punës së (AIUP-së) me rastin e hartimit të tij dhe akteve tjera përcjellëse.
- III. Ky pëlqim hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Këshilli Drejtues i UP-së, në mbledhjen e mbajtur më 19.06.2025, pasi kishte shqyrtuar kërkesën e prof. Eliot Bytyçit, mësimdhënës në FSHMN, Departamenti i Shkencave Kompjuterike, dërguar përmes e-mailit të datës 29.5.2025, për themelimin e Qendrës për Inteligjencë Artificiale në Universitetin e Prishtinës (AIUP). Duke pasur parasysh që Inteligjenca Artificiale (IA) po transformon me shpejtësi çdo sektor, duke filluar prej kujdesit shëndetësor, ekonomisë e deri te arsimit dhe qeverisja, e që Universiteti i Prishtinës e konsideron si nevojë strategjike për zhvillimin kombëtar, konkurrencën ekonomike dhe progresin shoqëror, ngritja e një qendre të dedikuar për IA-në, që do të veprojë në kuadër të Universitetit të Prishtinës, është thelbësore për ta pozicionuar institucionin dhe kombin tonë në ballë të këtij revolucioni teknologjik. Themelimi i kësaj qendre për IA ka për synim që të jetë qendra kryesore ndërdisiplinore për Inteligjencën Artificiale në Kosovë dhe pjesë e qendrave simotra në Ballkanin Perëndimor, duke nxitur kërkime të përparuara, duke ushqyer talentet e ardhshme në IA dhe duke këshilluar mbi zhvillimin e përgjegjshëm të politikave të IA-së që adresojnë sfidat lokale dhe shfrytëzojnë mundësitë globale, për faktin se IA është bërë pjesë e shoqërive, akademive, dijes dhe arsimit në përgjithësi, andaj me themelimin e saj synohet të krijohen vlera strategjike për shoqërinë tonë, e që do të përfshijë multidisiplinaritet, duke ofruar ekspertë të fushave të ndryshme si Shkencë Kompjuterike, Inxhinieri, Edukim, Ekonomi, Juridik, Mjekësi e të tjera. KD-ja e konsideron të arsyeshme iniciativën për themelimin e Qendrës për Inteligjencë Artificiale në kuadër të UP-së, për të qenë në hap me trendet botërore të zhvillimit të talentëve të reja për të ardhmen –ndërlidhje me IA-në, si dhe angazhimin e Qendrës për zhvillim të kurrikulave për arsimin fillor, të mesëm e të lartë, duke siguruar që studentët të marrin dijen e nevojshme për të ardhmen e që si aktivitete bazë të kësaj qendre do të jenë: hulumtimi dhe projektet, zhvillimi i kurrikulave, krijimi i politikave dhe ndërtimi i kapaciteteve për IA e të tjera. Andaj, duke marrë parasysh atë çfarë u tha më lart dhe mbi këtë bazë, KD-ja vendosi për dhënien e pëlqimit me rastin e iniciativës për themelimin e Qendrës për Inteligjencë Artificiale në kuadër të Universitetit të Prishtinës (AIUP).

Pëlqimi t'u dorëzohet:

1. Arkivit të UP-së,
2. Këshillit Drejtues të UP-së,
3. Parashtruesit të kërkesës,
4. Dekanit të FSHMN-së,
5. Zyrës Ligjore të UP-së,

Këshilli Drejtues i UP-së
Altin Samiti, kryesues